REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fag/Br.str. 1199
Data/Datum 29. 09. 2026
KOMUNA E FUSHË KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

Data: 29.09.2026

Duke u bazuar në konkursin nr. 1318, të datës 03.08.2026, të hapur për pozitën mësimdhënës klasor në SHFMU "Shfmu "Mihal Grameno" Aneksi 1, Shfmu "Mihal Grameno" Cikli 1-5, Shfmu "Mihal Grameno" Aneksi 2, Shfmu "Vëllezërit Frashëri"nenit 30 paragrafi 7 i regullores (qrk) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (ieaa) të arsimit parauniversitar dhe në pikët e fituara nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, komisioni përzgjedhës merr :

VENDIM

Për korrigjimin dhe saktësimin e vendimit të komisionit përzgjedhës me numër 2006 të datës 28.09.2026

1. Korrigjohet dhe saktësohet pjesa e Vendimit të Komisionit Përzgjedhës, e datës 28.09.2026,me numër 2006, që ka të bëjë me caktimin e vendeve të punës për kandidatët e renditur në listën përfundimtare.

2. Në përputhje me rezultatet e vlerësimit, pikët e fituara nga kandidatët dhe renditjen përfundimtare, si dhe pas verifikimit të natyrës dhe gjendjes faktike të vendeve të punës në institucionet përkatëse sipas konkursit, bëhet saktësimi i caktimit të vendeve të punës si vijon:

   2.1 **Gentiana Tërnava Sllamniku**, e renditur në pozitën nr. 4 me 74.3 pikë, caktohet në SHFMU "Mihal Grameno" Cikli 1-5 – vend i lirë;

   2.2 **Ilirjana Mehanja Berisha**, e renditur në pozitën nr. 6 me 74.0 pikë, caktohet në SHFMU "Mihal Grameno" Aneksi 2 – zëvendësim.

   2.3 **Mimoza Ahmeti Jashari ,** e renditur ne pozitën numër 5 me 74.1 pikë, caktohet në SHFMU "Mihal Grameno" Aneksi 2-zëvendësim .

3. Pjesët e tjera të Vendimit të Komisionit Përzgjedhës, nr. 2006, të datës 28.09.2026, të cilat nuk janë objekt i këtij korrigjimi dhe saktësimi, mbeten të pandryshuara.

4. Ky korrigjim nuk ndryshon pikët e fituara nga kandidatët, rezultatet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë, por ka për qëllim saktësimin e caktimit të vendeve të punës në përputhje rezultatet e vlerësimit, gjendjen faktike dhe natyrën e vendeve të punës të përfshira në konkurs.

5. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Komisioni Përzgjedhës, pas rishikimit të dokumentacionit të Konkursit nr. prot. 1318, të datës 03.08.2026, si dhe pas verifikimit të vendeve të punës për pozitën e mësimdhënësit klasor, ka konstatuar nevojën për saktësimin e caktimit të vendeve të punës për kandidatët përkatës.

Saktësimi është bërë duke marrë për bazë rezultatet e arritura gjatë procesit të vlerësimit, pikët e fituara nga kandidatët, renditjen përfundimtare, si dhe gjendjen faktike dhe natyrën e vendeve të punës në institucionet edukativo-arsimore të përfshira në konkurs.

Gjatë verifikimit të të dhënave të pasqyruara në Vendimin e Komisionit Përzgjedhës nr. 2006, të datës 28.09.2026, është konstatuar se caktimi i disa vendeve të punës nuk ishte pasqyruar në mënyrë të saktë në raport me gjendjen faktike të vendeve të punës sipas konkursit dhe nevojat e institucioneve përkatëse.

Për këtë arsye, Komisioni Përzgjedhës ka bërë saktësimin e caktimit të vendeve të punës për kandidatët përkatës, me qëllim që të dhënat e paraqitura në vendim të jenë në përputhje me gjendjen faktike dhe natyrën e vendeve të punës të përfshira në procedurën e konkursit.

Ky saktësim nuk prek pikët e fituara nga kandidatët dhe as rezultatet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë, por vetëm rregullon pasqyrimin dhe caktimin e vendeve të punës në përputhje me rezultatet e procesit të përzgjedhjes dhe gjendjen faktike të vendeve të punës.

Andaj, Komisioni Përzgjedhës vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Këshillë Juridike : Aplikuesi i pakënaqur me vendimin për përzgjedhje, mund të ushtrojë ankesë në afat prej tetë (8) ditësh nga pranimi i vendimit, pranë Komisionit për Ankesa në Komunën e Fushë Kosovës

Komisioni përzgjedhës

1. Sadri Emini –Kryetar i Komisionit
2. Arjeta Hyseni- Anëtare
3. Haki Salihu